

AUTORITETI KONTRAKTOR :

BASHKIA VLORË

EMERTIMI PROJEKTIT :

RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLËS ARTISTIKE "NAIM FRASHËRI" NË QYTETIN E VLORËS

RELACIONI ARKITEKTONIK



PROJEKTUES :

"ARENA MK" SHPK NR.LIÇENCE : N.6774/9

DATA : KORRIK 2026

1. OBJEKTI EKZITUES : POZICIONI DHE PROBLEMATIKAT

Shkolla artistike “Naim Frasheri” pozicionohet pergjat Rruges “Lef Sallata” shume prane qendres se qytetit te Vlores. Objekti eshte l orientuar sipas drejtimet lindje-perendim, paralel me aksin e rruges ne drejtimin verior. Objekti ka nje forme gjeometrike te rregull ne plan, l kompozuar ne 2 volume 1 kat ne katin perdhe (salla e koncerteve dhe ambjenti palestres) dhe volumi kryesor l klasave mesimore me lartesi 3 kate. Aksesit kryesor realizohet permes portes hyrese pergjat trotuarit. Objekti ka nje forme planimetrike dhe volumore simetrike, sipas aksit qendror. Permes kolonades ne katin perdhe realizohet aksesit per ne 3 volumet perberese te objektit, salla e koncerteve dhe palestrata ne drejtimet lindore dhe perendimore, dhe objekti kryesor l klasave mesimore ne pjesen qendrore. Ne fasaden e pasme te objektit (drejtim jugor) pozicionohet nje shkalle emergjence me strukture metalike me aksesit ne shesh pushimi i shkalles.

Objekti eshte ndertuar perpara viteve 90’ me nje strukture konstruktive me mure mbajtese dhe trate te thelle beton arme ne nivelin e soletave. Muratura e jashtme eshte e perfunduar me suvatim. Salla e koncerteve e pozicionuar ne drejtimin lindor te katit perdhe, paraqet disa problematika ne nivelin e shtresave izoluese kunder lageshtires ne dysHEME, pjesen e xokolit dhe ne nivelin e tarraces. Keto demtime jane te dukshme ne pjesen e brendshme te objektit. Hapsira e skenes eshte mjaft e vogel dhe e pa pershtatshme per eventet dhe koncertet qe institucioni organizon gjate eventeve te ndryshme.



Fig.1 – Foto te Objektit (Gjendja Ekzistuese)

Salla e palestres sportive eshte e organizuar ne 2 ambjente te ndara me nje hapsire te pa pershtatshme per kryerjen aktivitetit mesimor sportiv. Organizimi nyjeve sanitare dhe gjendja ekzistuese eshte e pa pershtatshme per funksionin e tyre. Ne nivelin e katit perdhe mungon nje hapsire sanitare per personat me aftesi te kufizuar. Njekohesisht mungojne hapsira te pershtatshme teknike.

2. PROJEKT PROPOZIMI

Projekt propozimi synon rikonceptimin volumor dhe vizual të objektit në nivel fasade duke përdorur elemente strukturor dhe dekorativ duke unifikuar elementet perberes të objektit. Njekohesisht zgjidhja funksionale e objektit dhe organizimi i ambjenteve të brendshme do të realizohet sipas kërkesave specifike të stafit mesimor. Për të realizuar këto modifikime janë parashikuar prishje dhe zhvendosje të disa elementeve jo strukturor të objektit, si ndarje të brendshme muresh, veshje kolonash, dyer të brendshme dhe dritare ekzistuese. Këto elemente të nderhyrjes janë specifikuar në vizatimet perkatese të gjendjes ekzistuese dhe planit të shembjeve për të tre nivelet e objektit.

A. KONCEPTI VOLUMETRIK. TRAJTIMI I FASADES :

Shkolla Artistike “Naim Frashëri” është institucioni i vetëm arsimor i dedikuar artit në qytetin e Vlorës. Në ambjentet e kësaj institucioni janë arsimuar personalitete të rëndësishme në fushën e artit duke lënë një kontribut të cmtuar në pasurinë artistike të qytetit të Vlorës. Gjate hartimit të kësaj projekti janë analizuar artist dhe vepra të ndryshme (në fushën e muzikës dhe pikturës) të cilat janë bërë pjesë e pasurisë historike artistike të qytetit të Vlorës. Një nga fenomenet artistike më të suksesshme të kësaj pasurie artistike është padyshim grupi i “Trio Vlonjate”, të cilët përmes këngeve dhe kompozimeve të tyre e bënë kengen qytetare vlonjate pjesë të pasurisë kulturore të vendit, dhe krijuan një standart artistik i cili hodhi bazat e muzikës shqiptare për vitet në vazhdim. Njëra prej këngeve më të njohura “Thellezat që hedhin valle” është analizuar dhe përdorur si “koncept ide” për kompozimin e fasadës kryesore të objektit.



TRIOJA VLONJATE

NË MAJ TË VITIT 1950 U KRIJUA GRUPI KARAKTERISTIK I KËNGËS VLONJATE ME KOSTANDIN THANON, RESHAT OSMANIN DHE BESHARETË ISMAILIN. NDËRSA NË VITIN 1953 U AKTIVIZUA NË “TRION VLONJATE” E FAMSHMJA MELIHA DODA. NË FORMACIONIN E TRIOS RESHATI DHE MELIHAIJA ISHIN MARRËS, NDËRSA KOSTANDIN THANO ISHTË KTHYES.

TEMA QENDRORE E KËNGËS POPULLORE QYTETARE VLONJATE, MBETI DASHURIA, PËRHERË E PRANISHME NË JETËN E PËRDITSHME TË NJERIUT, NDJENJË E KONSIDERUAR NGA POPULLI SI BËRIM JETË DHE GËZIMI. BUKURIA, DËLIRESIA, THJESHTESIA DHE DASHURIA E MOSHËS KANË TINGËLLUAR TË FRESKËTA DHE TË NGROHTA, PLOT NGJYRË DHE TINGUJ, DUKE NA KUJTUAR SE Ç’FORCË KRUJËSE KA NJË POPULL ME TRADITË TË LASHTË MUZIKORE DHE MË BOTË TË PASUR SHPIRTERORE.

TRIOJA VLONJATE LINDI SI NJË FORMACION SPONTAN FOLKLORIK E MË VONË IJË NËNSHTRUA ORGANIZIMIT TË NDËRGJEGJSHËM TË INTONACIONIT MUZIKOR QYTETAR VLONJAT. AJO U KTHYE NË NJË ANSAMBL TË VËRTETË VOKAL, DUKE SJELLË VLËRA TË ARRIRA ESTETIKE E ARTISTIKE.



FORMA GJEOMETRIKE SIPAS FORMATIT AUDIO TË KËNGES ORIGJINALE

→ THELLEZAT QË HEDHIN VALLE R. OSMAN RENDONTROJA. (ORIGJINALE)www



"THELLEZAT QË HEDHIN VALLE" - TRIO VLONJATE (FORMATI AUDIO I KËNGES ORIGJINALE)




Fig.2 – Skic ide per konceptimin e fasades kryesore te objektit

Fasada e objektit do te rikonceptohet ne te gjithe siperfaqen e saj ne nivelin e trajtimit te materialeve dhe kompozimit volumor permes shtimit dhe integrimit te disa elementeve dekorative dhe funksional. Volumi 1 kat ne drejtimin lindor te objektit, ne te cilin do te vendoset salla e koncerteve do te zgjerohet ne drejtimin verior me 9m. Pjesa kendore do te trajtohet me nje vetrate xhami te valezuar me kend 45grad dhe konturim perimetral te thelle 1.25m duke perfshire vetraten e valezuar ne hapsiren e tij. Fasada kryesore e volumit 3kat, do te trajtohet me nje strukture rrjete metalike e distancuar 1.5m kundrejt fasades ekzistuese te objektit.



Fig.3 – Pamje 3d – fragmenti fasades se propozuar te objektit

Kolonat ekzistuese ne pjesen ballore do te rikonceptohen duke shtuar edhe Nr.6 kolona te reja me te njejtat permasa. Siperfaqja e tyre do te trajtohet me veshje mermeri me tekstone te kuqe/kafe e erret. Me te njejtin material mermeri do te trajtohet edhe pjesa e parapetit mbi kolonaden hyrese, deri ne lartesine e parapetit te volumeve anesore (palestra sportive dhe salla e koncerteve).

Dritaret e objektit do te rriten ne lartesine e tyre, duke zhvendosur 50cm murature ne pjesen fundore te tyre, duke arritur nje lartesi perfundimtare prej 200cm. Dritaret dhe vetratat do te trajtohen me kase dural e lyer me boje te zeze dhe shtrese dopio xham.

Fasada e objektit (muratura e jashtme ekzistuese) do te trajtohet me sistem kapot me termoizolim 5cm kundra zjarrit. Shtresa perfundimtare do te trajtohet me suvatim dhe lyerje boje hidro-plastike sipas tonaliteteve te percaktuara ne projektin teknik (vizatimi fasadat e propozuara te objektit).



Fig.4 – Pamje 3D – Pamje nga rruga kryesore/Fasada ballore e objektit

B. Organizimi FunkSIONAL dhe Ambjentet e Brendshme :

1.Kati Perdhe / Niveli 0 :

-Objekti zhvillohet ne 3 nivele. Aksesi kryesor I objektit pozicionohet ne pjesen qendrore te fasades ballore. Permes deres/vetrates hyrese realizohet aksesi ne hollin e katit perdhe. Ambjentet e brendshme jane te organizuara ne menyre lineare ne te dy anet e koridorit qendror qarkullues. Kafazi I shkalles I cili realizon qarkullimin vertikal ndermjet niveleve eshte pozicionuar ne pjesen qendrore, perball hyrjes

kryesore ne nivelin e katit perdhe. Ne drejtimin jugor jane pozicionuar 6 klasa mesimore, dhe 2 ambjente poshte rampes se shkalles (ne kuoten -0.55cm) te cilat jane ne funksion te personelit sanitar. Ne drejtimin verior jane pozicionuar 8 ambjente zyrash per administraten, dhe 3 ambjente klasash mesiore per instrumente te caktuara. Ne dy drejtimet fundore te koridorit jane pozicionuar nyjet sanitare per nxenesit dhe stafin mesimor. Ne drejtimin perendimor te koridorit eshte pozicionuar dalja e emergjences.




Fig.5 – Planimetria e Katit Perdhe / Plani I Propozuar

-Salla e koncerteve ka nje akses te vecuar ne pjesen fundore te kolonades ne katin perdhe. Hapsira e salles do te zgjerohet me 9m ne drejtimin verior te saj, duke zmadhuar hapsiren e skenes dhe kapacitetin total te spektatoreve. Hapsira e uljes do te trajtohet me shkallare betoni, per te diferencuar rreshtat e uleseve te spektatoreve sipas kuotave te ndryshme per te rritur shikueshmerine dhe pamjen vizuale te skenes. Kapaciteti maksimal I salles do te jete prej 96 spektatoresh

-Palestra sportive aksesohet permes koridorit qendror ne katin perdhe, ne drejtimin perendimor. Ne pjesen fundore te kolonades pozicionohet dalja e emergjences (hapsira e deres ekzistuese per te aksesuar palestren sportive). Fusha sportive ka nje hapsire prej 16m x 7.5m, dhe siperfaqja e saj do te trajtohet me parket druri sipas kerkesave teknike per fushat e lojrave sportive. Ne pjesen anesore do te pozicionohen dy ambjente garderbash per nxenesit gjate orarit mesimor.

2.Kati I Pare / Niveli 1:

-Nivei I katit te pare aksesohet permes shkalles se brendshme. Ambjentet e brendshme jane te organizuara ne menyre lineare ne te dy anet e koridorit qendror qarkullues. Ne drejtimin jugor jane pozicionuar 5 ambjente klasash mesimore, 2 ambjente zyresh dhe zyra e drejtorise. Ne drejtimin verior jane pozicionuar nyjet sanitare ne dy skajet fundore e koridorit qarkullues, 1 ambjent klase laborator informatike, 1 ambjent klase mesimore, salla e mesueseve, nje ambjent zyre per administraten, dhe nje ambjent galerie ku do te ekspozohen pikturat e studenteve. Ne pjesen fundore te koridorit eshte pozicionuar dalja e emergjences dhe shkalla e emergjences.




Fig.6 – Planimetria e Katit te Pare / Plani I Propozuar

3.Kati I Dyte / Niveli 3:

-Nivei I katit te pare aksesohet permes shkalles se brendshme. Ambjentet e brendshme jane te organizuara ne menyre lineare ne te dy anet e koridorit qendror qarkullues. Drejtimi lindor I ketij niveli eshte I organizuar ne formen e studio / zyrove individuale per stafin mesimor, dhe bllokun e nyjeve sanitare per personelin dhe nxenesit/klasat e ketij niveli. Drejtimi perendimor eshte I organizuar ne dy (2) ambjente klasash mesimore, dhe pese (5) ambjente klasash / studio pikturë. Ne pjesen fundore te koridorit eshte pozicionuar dalja e emergjences dhe shkalla e emergjences.




Fig.7 – Planimetria e Katit te Dyte / Plani I Propozuar




Fig.8 – Planimetria e Sistemeve te Jashtme / Plani I Propozuar

C. Trajtimi I Sistemimeve te Jashtme :

-Sheshit perreth objektit ne drejtimin verior eshte kryesisht I kufizuar permes nje muri rrethues I trajtuar me kangjella metalike ne pjesen e sipërme te tyre. Ky rrethim do te ruhet duke u trajtuar me lysterje me te njejtin tonalitet boje sikurse fasada e objektit (specifikimet sipas vizatimit teknik plani I sistemimeve te propozuara). Pjese e kangjellave metalike do te zvendesohen me kangjella te reja metalike me te njejtin tonalitet boje sikur muratura e objektit. Siperfaqja e sheshit do te trajtohet me beton dekorativ. Pergjate dy drejtimeve anesore kundrejt hyrjes ne objekt do te kompozohen kuadrate ne menyre asimetrike me stola te trajtuar me mermer dhe gjelberime me peme dhe shkurre/lule dekorative. Prane hyrjes do te pozicionohen vende parkimi per bicikleta. Hapsira e fushes se jashtme sportive do te rrethohet me rrjete metalike dhe siperfaqja e saj do te trajtohet me beton/tartan me teksture te kuqe/kafe te erret per tu lidhur sa me mire me tonalitet e fasades se objektit. Hapsira anesore ku do te pozicionohet shkalla e emergjences do te trajtohet me rrethim metalik per tu vendosur depozitat e ujit (kerkese teknike sipas specifikime te projektit mekanik). Haspsira e pasme e objektit perdoret aktualisht si akses kalimi per disa shtepi private. Kjo hapsire do te qendroj e hapur dhe e aksesueshme duke u perdorur edhe si hapsire parkimi. Shkalla ekzistuese e emergjences e pozicionuar ne fasaden jugore te objektit do te riparohet dhe trajtohet me boje te pershtatshme per struktura metalike (me te njejtin tonalitet si fasada e objektit).



Fig.9 – Pamje Perspektive e Objektit / Projekt Propozimi



Fig.10 – Pamje Perspektive e Objektit / Projekt Propozimi